

KËRKESË
Nr. 328/9, datë 7.8.2026

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësimin shpall kërkesën “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM-në nr. 896, datë 29.12.2022, ‘Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor ‘Rishikimi i projektit për segmentin rrugor të vazhdimit të ‘Unazës së Madhe’ Tiranë nga ‘Sheshi Shqiponja – Bulevardi i ri’ dhe ‘Rikualifikimi i ‘Unazës Lindore’ për lotet 4,5,6, (faza 2)’”, të ndryshuar”.

Subjekti kërkues i këtij projekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilët do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur për pasuritë e llojit “truall”, bazuar në vendimin nr. 89, datë 3.2.2016, të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”, si dhe bazuar në vendimin nr. 138, datë 23.2.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive, pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, për pasuritë e llojit “ndërtesë banimi”, sipas tabelës paraprake bashkëlidhur.

Personat që preken nga ky projekt, të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar, dhe personat të cilët preken por nuk figurojnë në këto lista, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehen nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimet.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 39,243,242.9 (tridhjetë e nëntë milionë e dyqind e dyzet e tre mijë e dyqind e dyzet e dy pikë nëntë) lekë, me efekt financiar shtesë prej 1,571,991.9 lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Ermal Shena

TABELA PARAPRAKE E PASURIVE PËR SHPRONËSIM QË PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR “RISHIKIMI I PROJEKTIT PËR SEGMENTIN RRUGOR TË VAZHDIMIT TË ‘UNAZËS SË MADHE’, TIRANË NGA ‘SHESHI SHQIPONJA – BULEVARDI I RI’ DHE ‘RIKUALIFIKIMI I ‘UNAZËS LINDORE’ PËR LOTET 4, 5, 6’”, FAZA 2

Nr.	Emri	Adësia	Mbiemri	Zona kadastrale	Numri i pasurisë	Lloji i pasurisë	Tokë “arë”				Tokë “truall”				Ndërtesë soc.-ek.			Objekt banimi				Vlera totale (lekë)	Shënime
							Sip. totale m²	Sipërfaqja e shpronësuar (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera lekë	Sip. totale m²	Sipërfaqja e shpronësuar (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera lekë	Sip. totale m²	Sipërfaqja e shpronësuar (m²)	Vlera sipas preventivit lekë	Sip. totale m²	Sipërfaqja e shpronësuar (m²)	Çmimi (lekë/m²)	Vlera lekë		
6	Ismail	Oqerim	Skeja	3976	35/62	Truall					572.7	443.8	479.0	212.580.2					638.1	61.167.0	39.030.662.7	39.243.242.9	
TOTALI											572.7	443.8	479.0	212.580.2					638.1	61.167.0	39.030.662.7	39.243.242.9	

Efeki financiar shitesë është 1,571,991.9 lekë.